

Në bazë të nenit 25 paragrafi 4 të Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2013, 137/2013, 41/2014, 44/2015, 6/2016, 53/2016, 190/2016 dhe 64/2018), Bordi Drejtues i Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, në seancën e mbajtur më 08.05.2018 në Shkup, miratoi:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E INSTRUMENTEVE MBËSHTETËS TË FONDIT PËR INOVACIONE DHE ZHVILLIM TEKNOLOGJIK

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në këtë Rregullore për menaxhimin e instrumenteve mbështetës të Fondit për Inovacione dhe Zhvillimin Teknologjik, shprehjet e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

1. "Udhëzime antikorruptive" do të thotë "Udhëzime për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsioni në projektet e financuara nga kreditë e Bankës Botërore dhe kreditë dhe grantet nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim", më datë 15 tetor 2006, reviduar në janar 2011.
2. "Aplikues" nënkupton subjekt që deri te Fondi ka paraqitur projekt propozim në thirrje publike të hapur për ndarjen e fondeve në kuadër të instrumenteve mbështetëse të Fondit.
3. "Marrëveshje për shpërndarjen e mjeteve" është marrëveshje ndërmjet Fondit dhe shfrytëzuesit të përzgjedhur, për ndarjen e mjeteve, e lidhur në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Menaxhimit, si dhe në Rregulloren për instrumentet përkatëse të Fondit, të pranueshme nga Banka Botërore.
4. "Strukturë themeluese me shumicë dominuese maqedonase" nënkupton, në rast kur shfrytëzues është shoqatë ose fondacion i themeluar në përputhje me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet, struktura e themeluesve të shfrytëzuesit në të cilën së paku gjysma e numrit të themeluesve plus një do të jenë: 1) personat fizik të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë ose 2) personat juridikë të themeluar në Republikën e Maqedonisë, të cilët janë: a) shoqëri tregtare me shumicë dominuese maqedonase dhe b) Institucion(et) i/e lartë(a) arsimor(e) ose shkencor(e) dhe kërkimor (e) i/të themeluar(a) në Republikën e Maqedonisë;
5. "Pronësia me shumicë dominuese maqedonase" nënkupton, në rast kur shfrytëzues është shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare, struktura e bashkëpronarëve ose aksionarëve në atë shfrytëzues në të cilën personi fizik i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë (ose disa persona të tillë fizikë) dhe/ose person juridik i themeluar në Republikën e Maqedonisë (ose disa persona të tillë juridikë), individualisht ose bashkërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi zotërojnë një aksion, d.m.th. aksione në të cilën në kapitalin themelor të shfrytëzuesit janë të perfaqësuar me më shumë se 50% (domethënë të paktën 50%+1).
6. "Instrument për mbështetje" është instrument për mbështetje i ofruar nga Fondi në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregulloreje menaxhimi.
7. "Komision për miratimin e investimeve" është komision i përbërë nga ekspertë ndërkombëtarë, i krijuar në përputhje me Ligjin për veprimtari të inovacionit, i cili kryen punën e tij në përputhje me Ligjin, Rregulloren e Menaxhimit dhe Rregulloren e Punës së Komitetit.

8. "Shfrytëzues" nënkupton subjekt juridik që ka nënshkruar marrëveshje për ndarjen e mjeteve me Fondin.

9. "Grant i kofinancuar" është grant i dhënë nga Fondi për shfrytëzues specifik për financim të punëve, mallrave, konsulencës dhe shërbimeve të tjera në përputhje me aplikacionin e projektit të miratuar dhe buxhetin e projektit të bashkefinancuar nga shfrytëzuesi në përputhje me kushtet e përcaktuara në këto rregullore të menaxhimit, si dhe në rregulloret për instrumentin përkatës të Fondit.

10. "Udhëzime për konsultime" do të thotë "Udhëzimet: përzgjedhja dhe angazhimi i konsulentëve për hua nga Banka Botërore dhe kreditë dhe grantet e Shoqatës ndërkombëtare të zhvillimit nga huamarrësit e Bankës Botërore", nga janari 2011.

11. "Udhëzime për furnizime" do të thotë "Udhëzimet për furnizimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve jokonsulente në kuadër të huave të Bankës Botërore dhe kreditë dhe grantet e Shoqatës ndërkombëtare për zhvillim nga ana e shfrytëzuesve të mjeteve nga Banka Botërore", në janar 2011.

12. "Plani për menaxhimin me mjedisin jetësor" nënkupton plan për menaxhim me mjedisin jetësor për projektet inovative të pranueshme nga Banka Botërore, në të cilin jepet informacion i detajuar mbi masat që janë të përshtatshme ose të nevojshme për të maksimizuar përfitimet e projektit, heqjen, kompensimin ose zbutjen e gjithë efekteve të pafavorshme në mjedis, d.m.th. reduktimi i efekteve të tilla në nivel të pranueshëm, së bashku me buxhetin dhe vlerësimet e shpenzimeve, burimet e financimit, aranzhimet e duhura institucionale dhe rregullimet e monitorimit dhe raportimit që mundësojnë zbatimin e duhur dhe ofrimin e reagimeve të rregullta mbi përputhshmërinë me planin e tillë të menaxhimit me mjedisin jetësor.

13. "Trajnim" nënkupton kurse trajnimi, mentorim, shërbime për konsultime, vizita studimore, seminare, punëtori dhe aktivitete të tjera për bartjen e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

14. "Rregullore për Menaxhim" nënkupton kjo rregullore për menaxhimin e instrumenteve për mbështetjen e Fondit të Inovacionit dhe Zhvillimit Teknologjik.

15. "Propozim-projekt" është projekt i paraqitur në thirrje të hapur publike për ndarjen e mjeteve në kuadër të instrumenteve mbështetëse të Fondit, i cili synohet të financohet nëpërmjet një granti të kofinancuar ose huasë me kusht, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren për punë operative dhe Rregulloren për instrument përkatës të Fondit.

16. "Ndryshim i pronësisë së kapitalit" nënkupton, në rast kur shfrytëzuesi është shoqëri tregtare e krijuar në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, blerjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, gradualisht ose menjëherë, të një aksioni, me saktë aksioneve të kapitalit themelor të atij shfrytëzuesi, nga çdo person fizik ose juridik me anë të shitjes, dhuratës, trashëgimisë (përfshirë në rast vdekjeje të bashkëpronarit të shumicës, d.m.th. aksionarit të shfrytëzuesit), likuidimit, ndryshimit të statusit ose llojit tjetër të kontratës ose transferim, i cili nuk përbën ndryshim të pronësisë me shumicë dominuese maqedonase"

17. "Ndryshim i pronësisë me shumicë dominuese maqedonase" nënkupton, në rast kur shfrytëzuesi është shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare,

blerje direkte ose indirekte të një aksioni, gjegjësisht aksioneve që përfaqësohen me më shumë se 50% të kapitalit themelor të atij shfrytëzuesi (d.m.th., të paktën 50%+1) me anë të shitjes, dhuratës, likuidimit, ndryshimit të statusit ose një lloj tjetër kontrate ose transferimi, përveç me anë të trashëgimisë në rast vdekjeje të bashkëpronarit, gjegjësisht aksionar i shfrytëzuesit, nga personi fizik i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë ose nga personi juridik i themeluar në Republikën e Maqedonisë, i cili deri në lidhjen e marrëveshjes për ndarjen e mjeteve ndërmjet Fondit dhe atij shfrytëzuesi: a) nuk ka qenë bashkëpronar, pra aksionar i shfrytëzuesit; ose b) ka qenë bashkëpronar, pra aksionar i shfrytëzuesit që nuk zotëron aksion, pra aksione që përfaqësohen me më shumë se 50% në kapitalin themelor të atij shfrytëzuesi (d.m.th. të paktën 50%+1)".

18. "Ndryshim në strukturën themeluese me shumicë maqedonase" në rast kur shfrytëzues është shoqatë ose fondacion i themeluar në përputhje me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet, nënkupton ndryshim në strukturën themeluese të shfrytëzuesit që ekziston në kohën e lidhjes së marrëveshjes për ndarjen e mjeteve ndërmjet Fondit dhe atij shfrytëzuesi, si rezultat i së cilës ndryshon numri, identiteti ose përfaqësimi shumicë i themeluesve të shfrytëzuesit, të cilët janë: 1) personat fizikë shtetas të Republikës së Maqedonisë ose 2) persona juridikë të themeluar në Republikën e Maqedonisë, të cilët janë: a) shoqëri tregtare në pronësi shumicë dominuese maqedonase dhe b) institucion(et) i/e lartë(a) arsimor(e) ose shkencor(e) dhe kërkimor(e) i/të themeluar(a) në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht me përjashtimin e themeluesve të tillë ose përfundimin e anëtarësimit të tyre si rezultat i likuidimit ose ndryshimit të statusit (përveç rastit të vdekjes së themeluesit të personit fizik), si dhe përmes aderimit të themeluesve të rinj të cilët janë persona fizikë të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë ose persona juridikë të themeluar në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me ligjin dhe statutin e shfrytëzuesit.

19. "Ndryshim i strukturës themeluese" nënkupton, në rast kur shfrytëzues është një shoqatë ose fondacion i krijuar në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet, ndryshimi në strukturën themeluese të shfrytëzuesit që ekziston në momentin e lidhjes së marrëveshjes për ndarjen e mjeteve ndërmjet Fondit dhe atij shfrytëzuesi (përfshirë në rast të vdekjes së themeluesit të shfrytëzuesit i cili është person fizik, shtetas i Republikës së Maqedonisë), që nuk paraqet ndryshim në strukturën themeluese me shumicë maqedonase.

20. "Rezultatet e projektit" do të thotë çdo rezultat material ose jomaterial i projektit i mbuluar nga marrëveshja e ndarjes së mjeteve, të tilla si të dhëna, njohuri ose informacion, në çfarëdo forme dhe të çdo natyre, pavarësisht nëse ato mund të mbrohen ose jo, me të cilat jepen nëpërmjet aktiviteteve të projektit, si dhe çdo të drejtë mbi to, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.

21. "Ndryshim i statusit" nënkupton ribashkimin, lidhjen dhe ndarjen e shoqërisë tregtare në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me Ligjin për shoqëritë tregtare, përkatësisht ribashkimin, bashkimin dhe ndarjen e organizatës në mënyrën dhe në kushtet e përcaktuara nga Ligji për Shoqatat dhe Fondacionet.

22. "Hua e kushtëzuar" është një hua e dhënë nga Fondi për shfrytëzues specifik për financimin e punimeve, mallrave, konsulencës dhe shërbimeve të tjera në përputhje me projekt-aplikacionin e miratuar dhe buxhetin e projektit të bashkëfinancuar nga shfrytëzuesi në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore menaxhimi, si dhe në Rregulloren për instrumentin përkatës të Fondit.

23. "Fond" nënkupton Fondin për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik.

24. "Ekspertë për vlerësim" janë bashkëpunëtorët ekspertë të jashtëm të punësuar nga Fondi në përputhje me Rregulloren për mënyrën e përfshirjes dhe punës së ekspertëve në punën e Fondit gjatë vlerësimit dhe dhënies së mendimit, për qëllime të zbatimit në Fazën e parapërzgjedhjes së propozim-projekteve të paraqitura në kuadër të instrumenteve të Fondit".

Neni 2

(1) Me këtë Rregullore për menaxhim, ndër të tjera rregullohen: kriteret dhe procedurat për ndarjen e mjeteve, përmbajtjen e thirrjes publike për ndarjen e mjeteve, mënyrën e vlerësimit të projekt propozimeve të dorëzuara, mënyrën e monitorimit të realizimit të projekteve të miratuara, mbajtjen e evidencës së të dhënave për shfrytëzuesit e mjeteve të ndara nga Fondi dhe çështje të tjera që lidhen me punën e Fondit.

(2) Kjo Rregullore e Menaxhimit përmban:

- kriteret dhe kushtet për ndarjen e mjeteve nga instrumentet e Fondit;
- procedurat për ndarjen e mjeteve nëpërmjet instrumenteve të Fondit;
- rregullat për pagesën e mjeteve;
- rregullat për zbatimin e projekteve të mbështetura nëpërmjet instrumenteve të Fondit;
- rregullat për mbikëqyrje, monitorim dhe vlerësim;
- kushtet për pezullimin dhe përfundimin e përkohshëm të financimit;
- rregullat për ofrimin e trajnimeve për shfrytëzuesit e mjeteve nga Fondi;
- mekanizmat për mbrojtjen e fondeve të dhëna përmes instrumenteve të Fondit; dhe
- çështje të tjera nga puna e Fondit

II. MISIONI, STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE INSTRUMENTET E FONDIT

Neni 3

(1) Misioni i Fondit është të inkurajojë dhe mbështesë aktivitetin inovativ të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për të arritur zhvillim të përshpejtuar teknologjik bazuar në transferimin e njohurive, kërkimin për zhvillim dhe inovacionet që kontribuojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen dhe zhvillimin ekonomik, në të njëjtën kohë duke përmirësuar mjedisin e biznesit për zhvillimin e një avantazhi konkurrues të ndërmarrjeve.

(2) Struktura drejtuese e Fondit përbëhet nga:

- Bordi Drejtues;
- Komiteti i Miratimit të Investimeve (në tekstin e mëtejshëm: "Komiteti");
- Drejtori.

(3) Veprimtaria, organizimi i brendshëm dhe mënyra e funksionimit, si dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Fondit dhe çështje të tjera me rëndësi për funksionimin e Fondit rregullohen me Ligjin për veprimtarinë inovative, Statutin e Fondit, Rregulloren për sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të Fondit, Rregulloren e punës së Bordit Drejtues, Rregulloren e Punës së Komisionit dhe aktet e tjera të brendshme të Fondit.

Neni 4

(1) Fondi jep mjete përmes instrumenteve mbështetëse të mëposhtme:

- Grante të bashkëfinancuara për shoqëritë tregtare të sapothemeluara: start-up dhe spin-off;¹

¹ Grante të vogla për koncept të vërtetuar

- Grante të bashkëfinancuara dhe kredi të kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve;²
- Grante të bashkëfinancuara për zgjerim teknologjik;³ dhe
- Grante të bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit.⁴

(2) Karakteristikat themelore të instrumenteve, si dhe kriteret e veçanta të pranueshmërisë, përshkruhen në detaje dhe përpunohen në rregullore të veçanta për instrumentet mbështetëse të miratuara nga Bordi Drejtues i Fondit.

III. PROCEDURA E NDARJES SË MJETEVE PËRMES INSTRUMENTEVE TË FONDIT

Neni 5

(1) Për çdo ndarje të mjeteve përmes instrumenteve të Fondit, Fondi publikon thirrje publike, e cila paraprakisht i është dorëzuar Bordit Drejtues si informacion. Thirrja publike duhet të publikohet në të paktën dy gazeta publike dhe në faqen e internetit të Fondit.

(2) Afati për dorëzimin e propozim-projektit do të caktohet prej 30 (tridhjetë) deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së thirrjes publike.

Neni 6

(1) Thirrja publike domosdoshmërisht duhet të përmbajë këto të dhëna:

- të dhëna për organin që e ka lëshuar thirrjen;
- data e publikimit të thirrjes publike;
- mënyra e paraqitjes së projekt propozimit dhe dokumentacionit shoqërues;
- afati për dorëzimin e propozim-projektit
- përshkrim të shkurtër të instrumentit, duke përfshirë kriteret e pranueshmërisë së aplikuesit, aktivitetet dhe shpenzimet e pranueshme për financim;
- buxhetin total për thirrjen si dhe mundësinë e rialokimit të mjeteve të pandara në një thirrje tjetër sipas të njëjtit instrument ose deri në 30% të buxhetit për një instrument në buxhet në një instrument tjetër brenda së njëjtës thirrje;
- informacionet për kontakt.

(2) Të gjitha të dhënat e mësipërme duhet të përmbahen në thirrjen publike të plotë të publikuar në faqen e internetit të Fondit. Për thirrjen publike të publikuar ne mediat publike do të përgatitet një version i shkurtër.

Neni 7

(1) Me aplikimin për marrjen e mjeteve financiare përmes cilitdo instrument nga Fondi, duhet të dorëzohen dokumentet e mëposhtme:

1. Dokumentacioni i projektit (i cili përmban formularët e propozim-projektit, të disponueshëm përmes faqes së internetit të Fondit):

- formularin e aplikimit të projektit të plotësuar siç duhet (nënshkruar dhe printuar nga përfaqësuesi i autorizuar);

² Grante dhe kredi të bashkëfinancuara për komercializim

³ Grante të bashkëfinancuara për zgjerimin e teknologjisë në sektor

⁴ Krijimi i përshejtuesve

- formularin e buxhetit të projektit të plotësuar siç duhet (nënshkruar dhe printuar nga përfaqësuesi i autorizuar);
- deklaratën e aplikuesit për pranimin e kushteve të Fondit (Shtojca 1 e këtyre Rregullave të Menaxhimit), e nënshkruar dhe e vulosur nga përfaqësuesi i autorizuar;
- pyetësor mjedisor i plotësuar siç duhet (i firmosur dhe printuar nga përfaqësuesi i autorizuar), me përjashtim të instrumentit mbështetës
- granteve të bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit, ku Përshejtuesi është i detyruar të nënshkruajë deklaratë për mjedisin jetësor me të cilën vërteton do të sigurojë që shfrytëzuesit e përshejtuesit të respektojnë procedurat e parashikuara në dokumentin e Kornizës së Menaxhimit së mjedisit jetësor.

2. Dokumentacioni në lidhje me aplikuesin:

Për të gjitha instrumentet mbështetëse nga Fondi, përveç instrumentit mbështetës – Grante të bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit:

- biografi të shkurtra të personave kryesorë të përfshirë në projekt (maksimumi pesë persona);
- gjendja aktuale e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më i vjetër se (gjashtë) muaj;

Rreth instrumenteve mbështetëse – Grante të bashkëfinancuara për shoqëritë tregtare të sapothemeluara: start-ups dhe spin-offs dhe grante të bashkëfinancuara dhe kredi të kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve:

- kopjen e bilancit të suksesit të dorëzuar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë për dy vitet e mëparshme, me përjashtim të ndërmarrjeve të cilat janë regjistruar në të njëjtin vit kur është dorëzuar projekt propozimi.

Për instrumentin mbështetës – Grantet e bashkëfinancuara për zgjerimin teknologjik në varësi të Fazës për të cilën aplikohet, aplikuesi/shfrytëzuesi duhet të dorëzojë gjithashtu dokumentet e mëposhtme në lidhje me Përdoruesit fundor nëse është e aplikueshme, pra përpara zbatimit të Fazës 2:

- Gjendja aktuale e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj për secilin nga përdoruesit fundor.
- bilanci i suksesit e dorëzuar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë për dy vitet e mëparshme për secilin nga shfrytëzuesit e fundit, me përjashtim të ndërmarrjeve të cilat janë regjistruar në të njëjtin vit kur është dorëzuar propozim-projekti.

Për instrumentin mbështetës – Grante të bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit:

- biografite e menaxherëve të Përshejtuesit, biografite e ekipit operacional të Përshejtuesit, lista e ekspertëve/mentorëve të përfshirë në punën e Përshejtuesit;
- gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë (jo më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj.
- nëse ka, bilanci i suksesit i dorëzuar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë për dy vitet paraprake, me përjashtim të institucioneve publike dhe ndërmarrjeve të sapothemeluara që janë regjistruar në të njëjtin vit kur është dorëzuar propozim-projekti.

(3) Në rastin e propozim-projekteve që parashikojnë një qasje partneriteti (p.sh. konsorcium, partneritet, etj.) aplikuesi duhet të dorëzojë gjithashtu marrëveshje konsorciumi dhe/ose marrëveshje bashkëpunimi, përkatësisht, me të drejta të rregulluara, detyrime, marrëdhënie pronësie dhe person të autorizuar. Në rast se propozim-projekti përmban një partneritet strategjik për instrumentin mbështetës – grante të bashkëfinancuara për krijimin, funksionimin dhe

investimin e përshpejtuesve të teknologjisë së biznesit, aplikuesii duhet të dorëzojë marrëveshje bashkëpunimi me të drejta dhe detyrime të rregulluara me organizata/individë me përvojë ndërkombëtare në krijimin dhe menaxhimin e përshpejtuesit të teknologjisë së biznesit.

(4) Aplikacioni për projektin, buxheti i projektit dhe biografitë duhet të dorëzohen në gjuhën maqedonase dhe angleze. Dokumentacioni në lidhje me aplikuesit duhet të dorëzohet vetëm në gjuhën maqedonase.

(5) Dokumentacioni i projektit duhet të dorëzohet në formularët e përgatitur nga Fondi.

(6) Në rast se projekti bazohet në të drejta tashmë ekzistuese të pronësisë intelektuale, aplikuesi është i detyruar të paraqesë, së bashku me dokumentacionin e projektit, vërtetimin e së drejtës së shfrytëzimit të pronësisë intelektuale në formën e një marrëveshjeje licencimi, marrëveshjet për kontributet "in-kind" ose një lloj tjetër marrëveshjeje që konfirmon se aplikuesii ka të drejtë të shfrytëzojë pronësinë intelektuale në të cilën bazohen rezultatet e projektit.

(7) Çdo projekt propozim i paraqitur në thirrje publike për ndarjen e mjeteve për Fondin ose për përshpejtuesit e teknologjisë së biznesit të financuar nga Fondi që ka ndikim në mjedis duhet të jetë në përputhje me politikat e mjedisit mjedisor të Bankës Botërore, Doracaku i Bankës Botërore për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes, Ligjin për mjedisin jetësor dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tjera përkatëse të Republikës së Maqedonisë.

(8) Fondi rezervon të drejtën, nëse është e nevojshme, të kërkojë dokumentacion tjetër nga aplikuesit.

Neni 8

(1) Në rast se aplikuesit i jepet financim, për të gjitha instrumentet mbështetëse, para nënshkrimit të marrëveshjes për ndarjen e mjeteve, aplikuesi duhet të paraqesë në Fond edhe:

- marrëveshje me palë të treta të rëndësishme për zbatimin e projektit
- deklaratën e akumulimit të ndihmës shtetërore në tre vitet e fundit fiskale (nëse ka);
- Plani i Menaxhimit me mjedisin jetësor i nënshkruar dhe i printuar (nëse është e aplikueshme);
- informacion në lidhje me llogarinë e veçantë të hapur për projektin.

(2) Fondi rezervon të drejtën, nëse është e nevojshme, të kërkojë dokumentacion tjetër nga aplikuesit, të cilët janë të detyruar t'i dorëzojnë në kohën më të shkurtër të mundshme.

IV. VLERËSIMI I PROJEKTEVE TË PROPOZUARA

Neni 9

(1) Për të përcaktuar nëse projekti i propozuar është i plotë dhe në përputhje me kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në thirrjen publike dhe rregulloret për instrumentin përkatës, formohet një komision (ose komisione) për shqyrtimin administrativ të propozim-projekteve të pranuar. Komisioni (ose komisionet) shqyrtojnë secilin projekt të propozuar veçmas.

(2) Komisionin për shqyrtim administrativ të propozim-projekteve të pranuar e themelon drejtori ose personi i autorizuar nga drejtori dhe përbëhet nga së paku dy të punësuar.

(3) Komisioni për inspektim administrativ me rastin e inspektimit të propozim-projekteve udhëhiqet nga Dokumenti për shqyrtim administrativ të propozim-projekteve.

(4) Pas përfundimit të shqyrtimit administrativ të projekteve të propozuara, Komisioni për Shqyrtim Administrativ përpilon procesverbal.

(5) Nëse projekti i propozuar është i pakompletuar, d.m.th. aplikuesii nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar gjatë aplikimit në përputhje me nenin 7 të kësaj Rregulloreje të Menaxhimit ose buxheti i projektit është plotësuar gabimisht, Fondi e njofton Aplikuesin në

mënyrë elektronike dhe i jep mundësinë që brenda 5 (pesë) ditëve pune të dorëzojë dokumentet shtesë që mungojnë në mënyrë elektronike ose në arkivin e Fondit dhe/ose të dorëzojë buxhetin e korrigjuar të projektit. Në rast të dorëzimit shtesë të dokumenteve, nuk lejohen ndryshime në aplikacionin e projektit apo në buxhetin e projektit që nuk janë kërkuar nga Fondi.

(6) Nëse aplikanti nuk i dorëzon dokumentet që mungojnë as brenda 5 (pesë) ditëve shtesë të punës, ose aplikuesi dhe/ose anëtarët e konsorciumit/partnerëve nuk i plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në Rregulloren për instrumentin përkatës, Komisioni për shqyrtim administrativ shënon në procesverbal se ai propozim-projekt është i paplotë, pra se aplikanti dhe/ose anëtarët e konsorciumit/partnerëve janë të papërshtatshëm, për këtë arsye nuk do të vlerësohet nga ekspertët vlerësues dhe Komiteti.

(7) Procesverbalin nga paragrafi (4) i këtij neni, së bashku me dokumentet e kompletuara për shqyrtimin administrativ të propozim-projekteve, Komisioni për shqyrtim administrativ e përgatit në afat prej 20 (njëzet) ditësh pune nga dita e fundit e afatit për dorëzimin e projekt propozimeve.

(8) Të gjitha projektet e propozuara që janë dorëzuar me kohë, që janë të kompletuara dhe që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë së aplikuesit dhe/ose partnerëve, dorëzohen për vlerësim në fazën e parapërzgjedhjes në përputhje me procedurën nga neni 11 i kësaj Rregulloreje të Menaxhimit.

(9) Komisioni për shqyrtim administrativ, përveç procesverbalit, përgatit edhe tabelën e të gjitha propozim-projekteve të pranuar, e cila përmban këto të dhëna:

- emri i aplikuesit/anëtarit/partnerit të konsorciumit;
- strukturën e pronësisë së aplikuesit/anëtarit të konsorciumit/partnerit;
- Personi i autorizuar (menaxheri/drejtori) i aplikuesit/anëtarit të konsorciumit/partnerit.

(10) Tabela nga paragrafi (9) i këtij neni u dërgohet punonjësve të Fondit, drejtorit, anëtarëve të Këshillit drejtues, ekspertëve vlerësues dhe anëtarëve të Komisionit, me qëllim të konstatimit të konfliktit të mundshëm interesi në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

(11) Në rast se njëri nga ekspertët vlerësues konstaton konflikt interesi, ai është i detyruar të njoftojë Fondin sa më shpejt që të jetë e mundur. Fondi do ta përjashtojë personin e tillë nga procesi i vlerësimit (në fazën e para-përzgjedhjes) të atij propozim-projekti.

(12) Në rast se njëri nga anëtarët e Komisionit konstaton konflikt interesi, ai është i detyruar të njoftojë sa më parë Drejtorin e Fondit, pas së cilës do të përjashtohet nga procesi i vlerësimit (në fazën e përzgjedhjes) të atij projekti të propozuar.

(13) Në rast se disa anëtarë të Komisionit identifikojnë një konflikt interesi në lidhje me një projekt të caktuar të propozuar dhe ai projekt nuk mund të vlerësohet nga të paktën 3 (tre) anëtarë të Komitetit, projekti do të përjashtohet nga procedurat e mëtejshme dhe nuk do të vlerësohet.

Procesi i vlerësimit

Neni 10

(1) Shqyrtimi i propozim-projekteve, me përjashtim të instrumentit mbështetës, Grantet e bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit, bëhet në dy faza: në fazë parazgjedhjeje dhe në fazë përzgjedhëse në përputhje me nenin 11 dhe nenin 12 të kësaj Rregulloreje për menaxhim.

(2) Fazën e parazgjedhjes e kryejnë ekspertët vlerësues. Çdo propozim-projekt do të vlerësohet në këtë fazë nga dy ekspertë të fushave që korrespondojnë me kriteret e vlerësimit, domethënë me qëllimet e Instrumentit, dhe një person nga fusha që korrespondon me projekt propozimin.

(3) Fazën e përzgjedhjes e kryen Komisioni për Miratimin e Investimeve, i cili merr edhe vendimin përfundimtar për financimin.

(4) Në rastin e instrumentit mbështetës Grantet e bashkëfinancuara për krijimin, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit, shqyrtimi i projekteve të propozuara dhe vendimi përfundimtar për financimin merret nga Komiteti si rezultat i vetëm një faze të përzgjedhjes në përputhje me nenin 13 të kësaj Rregulloreje Menaxhimi.

Faza e parazgjedhjes

Neni 11

(1) Në fazën e parazgjedhjes, ekspertët vlerësues, të caktuar nga Fondi, kanë detyrimin të plotësojnë tabelat e vlerësimit për secilin prej propozim-projekteve të ndara dhe të japë mendim profesional dhe vlerësimin e propozim-projekteve brenda(7) shtatë ditëve pune nga dita e pranimit të propozim-projekteve.

(2) Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara për secilin propozim-projekt përcaktohet si mesatare e notave të marra nga ekspertët vlerësues të caktuar për të vlerësuar atë propozim-projekt në fazën parazgjedhore.

(3) Çdo projekt propozim që ka marrë 51 (pesëdhjetë e një) pikë ose më shumë (nga gjithsej 100 (njëqind) pikë) në fazën e para-përzgjedhjes kalon në fazën tjetër të përzgjedhjes.

(4) Çdo projekt i propozuar që ka marrë më pak se 51 (pesëdhjetë e një) pikë (nga gjithsej 100 (njëqind) pikë) në fazën para-përzgjedhëse refuzohet për financim nga instrumentet mbështetëse të Fondit.

(5) Çdo aplikues, projekt propozimi i të cilit nuk ka marrë 51 (pesëdhjetë e një) pikë ose më shumë, domethënë, projekti i të cilit nuk ka kaluar në fazën e përzgjedhjes, do të njoftohet menjëherë për rezultatet.

Faza e përzgjedhjes

Neni 12

(1) Në fazën e përzgjedhjes, çdo anëtar i Komisionit kryen vlerësim të propozim-projekteve që kanë kaluar fazën parazgjedhjes dhe ka detyrim të plotësojë Tabelën e Vlerësimit për secilin prej atyre propozim-projekteve dhe t'i vlerësojë ato brenda një periudhe të përcaktuar paraprakisht nga Fondi.

(2) Në rastet kur anëtarët e Komisionit kërkojnë pyetje shtesë në lidhje me aplikuesit dhe propozim-projekti të kontrollohet nga punonjësit e Fondit, punonjësit e Fondit japin informacionin e nevojshëm shtesë me anë të vizitave në terren tek aplikuesi, komunikim me personat kyç të propozim-projekteve dhe/ose verifikim administrativ i informacionit. Personat e emëruar janë të detyruar të japin informacionin e nevojshëm brenda një afati të caktuar paraprakisht.

(3) Në fazën e përzgjedhjes, propozim-projektet e parapërzgjedhura shqyrtohen gjithashtu nga një ekspert/ekspertë të mjedisit jetësor. Eksperti i mjedisit jetësor është i detyruar të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për vlerësimin e propozim-projekteve të parapërzgjedhura në përputhje me dokumentin Kornizë të Mbrojtjes së Mjedisit jetësor. Eksperti i mjedisit jetësor është i detyruar t'i paraqesë Fondit raport për kategorizimin e propozim-projekteve të parazgjedhura. Sipas Kornizës së Menaxhimit të mjedisit jetësor, Fondi nuk do të financojë projekte të kategorizuara nën "kategoria 3 - rrezik i lartë".

(4) Vlerësimet dhe mendimet profesionale të marra nga ekspertët vlerësues, raportet e kategorizimit të ekspertit mjedisor dhe raportet për informacione shtesë të dhëna nga punonjësit e Fondit, u dorëzohen të gjithë anëtarëve të Komisionit që janë të detyruar t'i marrin ato parasysht gjatë vlerësimit të propozim-projekteve.

(5) Bazuar në pikët e fituara, krijohet një listë treguese rradhitëse të propozim-projekteve të përzgjedhura. Lista paraqet mesataren e pikëve të marra nga ekspertët vlerësues, mesataren e pikëve të marra nga Komisioni (mesatarja e pikëve të marra nga secili anëtar i Komisionit), si dhe mesataren e pikëve të marra nga të dyja fazat.

Neni 13

(1) Në rastin e instrumentit mbështetës Grantet e bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit, çdo anëtar i Komitetit duhet të plotësojë tabelën për vlerësimin e propozim-projekteve dhe të vlerësojë propozim-projektin brenda një periudhe të përcaktuar paraprakisht nga Fondi.

(2) Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara për çdo projekt të propozuar përcaktohet si mesatare e notave të secilit prej anëtarëve të Komisionit.

(3) Bazuar në pikët e fituara, krijohet një listë treguese rradhitëse e propozim-projekteve të vlerësuara.

Vendimi për financim

Neni 14

(1) Vendimin përfundimtar për financimin e propozim-projekteve nga të gjitha instrumentet mbështetëse të Fondit e merr Komisioni në mbledhjen e mbajtur brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të propozim-projekteve në Komitet.

(2) Gjatë mbledhjes, Fondi mund të organizojë prezantim të propozim-projekteve të parapërzgjedhura. Në këtë prezantim, secili aplikues do të prezantojë shkurtimisht projektin e tij të propozuar, dhe anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të bëjnë pyetje për të marrë informacion shtesë që do t'i ndihmojë në marrjen e vendimit.

(3) Vendimin përfundimtar për financim, Komisioni e merr në mbledhje me votë publike "PËR" ose "KUNDËR" ndarjes së mjeteve për një propozim-projekt të caktuar të parapërzgjedhur. Fondet për një propozim-projekt të caktuar të parapërzgjedhur mund të ndahen vetëm nëse të paktën tre anëtarë të Komisionit kanë votuar "PËR" ndarjen e mjeteve për atë propozim-projekt.

(4) Gjatë marrjes së vendimit për financim, ndikon edhe buxheti financiar i disponueshëm për çdo thirrje publike. Komisioni mund të marrë vendim për financimin e projekteve të propozuara vetëm brenda buxhetit të përcaktuar për thirrjen publike.

(5) Nëse Komisioni merr vendim që është në kundërshtim me vlerësimin dhe mendimin profesional të përgatitur nga ekspertët vlerësues, ai duhet të përmbajë shpjegim të hollësishëm të arsyeve për marrjen e një vendimi të tillë.

(6) Nëse me instrument të caktuar, buxheti i përcaktuar në thirrjen publike është më i lartë se sa duhet, d.m.th. nuk ka mjaftueshëm propozim-projekte të miratuara për financim, mjetet e papërdorura mund të ripërdoren për një thirrje tjetër publike ose mjete në vlerë deri në 30% e buxhetit të thirrjes publike mund të rishpërndahet nga një instrument i Fondit në tjetrin në të njëjtën thirrje publike nëse për instrumentin tjetër ka më shumë projekte të propozuara të pranueshme për financim sesa shuma e përcaktuar për atë instrument në thirrjen publike.

(7) Konsolidimi i komenteve për propozim-projektet që janë refuzuar për financim në fazën e përzgjedhjes, bëhet nga një anëtar i Komisionit, i emëruar nga Fondi, i cili ka vlerësuar propozim-projektet.

(8) Çdo aplikues, propozim-projekti i të cilit ka kaluar fazën e përzgjedhjes, do të njoftohet për rezultatet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e vendimit përfundimtar për financimin nga Komisioni.

(9) Aplikuesit, projektet e propozuara të të cilëve nuk do të miratohen për financim, mund të riaplikojnë për mjete nga Fondi deri në tre herë me të njëjtin projekt të propozuar.

V. NDARJA E MJETEVE

Lidhja e Marrëveshjes për ndarjen e mjeteve

Neni 15

(1) Aplikuesit për të cilët është marrë vendim për financim do të ftohen të nënshkruajnë marrëveshje për ndarjen e mjeteve në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, Fondi mund ta shtyjë në rast të ekzistimit të arsyeve të mjaftueshme për këtë.

(3) Fondi dhe aplikuesi për të cilin është marrë vendim për financim do të lidhin një marrëveshje për ndarjen e mjeteve në formën dhe përmbajtjen esenciale të përcaktuar nga Fondi.

(4) Elementet obligative të kontratës për ndarjen e mjeteve përmes instrumenteve mbështetëse nga Fondi janë:

- palët kontraktuese;
- objekti i kontratës;
- interpretimi i përkufizimeve;
- vlera e kontratës;
- kohëzgjatja e projektit;
- të drejtat dhe detyrimet e Fondit dhe të shfrytëzuesit;
- fuqia madhore;
- zgjidhjen e kontratës; dhe
- dispozitat përfundimtare.

(5) Shfrytëzuesi është i obliguar që para nënshkrimit të marrëveshjes për ndarjen e mjeteve përmes njërit nga instrumentet për përkrahje nga Fondi, të hapë llogari të veçantë për projektin.

Pagesa e mjeteve

Neni 16

(1) Për të gjitha instrumentet mbështetëse, mjetet paguhen paraprakisht, në baza tremujore, në përputhje me buxhetin e projektit dhe dispozitat e përcaktuara në këtë Rregullore të Menaxhimit dhe në Rregulloren përkatëse për secilin nga instrumentet mbështetëse në përputhje me dinamikën e mëposhtme. :

- Për instrumentin mbështetës – grante të bashkëfinancuara për shoqëritë tregtare të sapothemeluara: start-up dhe spin-off dhe për Instrumentin Mbështetës – grante të bashkëfinancuara dhe kredi të kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve, mjetet paguhen në baza tremujore.

- Për instrumentin mbështetës – grante të bashkëfinancuara për shtrirje teknologjike, për Fazën 1 – Diagnostifikim dhe Plan të Përmirësimit të mjeteve, paguhen një herë, për Fazën 2 – Zbatimin, mjetet paguhen në baza tremujore.

- Për instrumentin mbështetës – grantet e bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit, mjetet për ngritjen dhe shpenzimet e funksionimit të përshejtuesit të teknologjisë së biznesit paguhen çdo tremujor, bashkëfinancimi për fillimin dhe investimet e mëvonshme në përdoruesit e përshejtuesit paguhen me një kërkesë të miratuar paraprakisht të shfrytëzuesit.

(2) Mjetet e përcaktuara në euro në Marrëveshjen për ndarje të mjeteve dhe buxheti i projektit do të paguhen në denarë maqedonase, në shumën e llogaritur sipas normës së kursit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e tërheqjes së mjeteve nga llogarinë valutore të Fondit.

Neni 17

(1) Mjetet për pagesën e parë do të paguhen në llogarinë e veçantë për projektin pas nënshkrimit të Marrëveshjes për ndarjen e mjeteve, pasi shfrytëzuesi i dorëzon Fondit vërtetimin e pagesës së bashkëfinancimit të tij për tremujorin e parë në formën e vërtetimit bankar, nëse është e aplikueshme.

(2) Çdo pagesë e rradhës do të paguhet në llogarinë e veçantë të projektit pasi të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- raport i miratuar për aktivitetet e realizuara më parë (pjesa përshkruese dhe pjesa financiare);
- të paktën 70% (shtatëdhjetë për qind) e mjeteve të buxhetuara më parë janë shpenzuar me qëllim

- dëshmi të dorëzuar të pagesës së kryer të bashkëfinancimit vetanak për tremujorin e ardhshëm në formë të vërtetimit bankar.

(3) Në rastin e instrumentit mbështetës - Grantet e bashkëfinancuara për themelimin, funksionimin dhe investimet e përshejtuesve të teknologjisë së biznesit, përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni, kusht për financim të mëtejshëm është edhe vlerësimi pozitiv i funksionimit të përshejtuesit i dhënë nga Komiteti në përputhje me procedurat e monitorimit të përcaktuara në Rregulloren e instrumentit përkatës.

(4) Procedura për të gjitha pagesat për përdoruesin, me përjashtim të pagesës së parë, do të fillojë në afat prej 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga dita e miratimit të raportit tremujor.

(5) Nga pagesat e fundit për përfituesin, Fondi ruan mjete në shumën prej:

- Për Instrumentin Mbështetës - grante të bashkëfinancuara për shoqëritë tregtare të sapothemeluara: start-ups dhe spin-offs dhe për Instrumentin Mbështetës. – grante të bashkëfinancuara dhe kredi të kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve, 5% (pesë për qind) të buxhetit total të projektit

- Për Instrumentin Mbështetës - Grantet e bashkëfinancuara për shtrirje teknologjike, 5% e totalit të bashkëfinancimit nga Fondi.

- Rreth Instrumentit Mbështetës - grante të bashkëfinancuara për themelim, punë dhe investime në përshejtuesit e teknologjisë të biznesit, 5% e shumës së bashkëfinancimit total nga Fondi i reduktuar nga kursimet e bëra gjatë zbatimit të projektit.

(6) Procedura për pagesën e mjeteve të mbajtura nga paragrafi (5) të këtij neni do të fillojë në afat prej 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga dita e miratimit të Raportit Përfundimtar për projektin (pjesa përshkruese dhe pjesa financiare).

(7) Në rast të mjeteve të pashpenzuara dhe/ose në rast të keqpërdorimit, shuma e duhur e mjeteve të mbajtura nuk i paguhet shfrytëzuesit.

Neni 18

(1) Shfrytëzuesi është i detyruar që rregullisht t'i shlyejë detyrimet e tij ndaj Fondit në bazë të shlyerjes së kredisë (principali dhe interesi), pagesa e royalty, të ardhurat nga shitja e investimit dhe strategji të tjera daljeje nga shfrytëzuesit e përshejtuesit.

- (2) Në rast të pezullimit ose ndërprerjes së marrëveshjes për ndarjen e mjeteve, Fondi rezervon të drejtën që të kërkojë nga shfrytëzuesi që t'i kthejë një pjesë ose të gjitha mjetet e marra, në përputhje me kushtet e marrëveshjes.
- (3) Pagesat e shfrytëzuesit për Fondin duhet të paguhet në denarë.
- (4) Fondi do të mbajë evidencë për përmbushjen e detyrimeve që shfrytëzuesit e mjeteve i kanë ndaj Fondit.
- (5) Për çdo vonesë në pagesën e mjeteve për shlyerjen e detyrimeve ndaj Fondit nga përfituesit për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, Fondi i dërgon shfrytëzuesit paralajmërimin e parë me shkrim për vonesën.
- (6) Për çdo vonesë në pagesën e mjeteve për mbulimin e detyrimeve ndaj Fondit nga përdoruesit për më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, Fondi i dërgon një paralajmërim të dytë me shkrim shfrytëzuesit për vonesën.
- (7) Për çdo vonesë në pagesën e fondeve për mbulimin e detyrimeve ndaj Fondit nga përfituesit për më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, Fondi rezervon të drejtën të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen për ndarjen e mjeteve dhe të aktivizojë instrumentet e mbrojtjes nëse e njëjta është paraparë.
- (8) Për çdo vonesë në pagesën e detyrimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, Fondi rezervon të drejtën të llogarisë dhe të arkëtojë interes ndëshkues në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë.

Neni 19

- (1) Shfrytëzuesi ka obligim që projektin ta realizojë në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore të Menaxhimit, në Rregulloren për instrumentin përkatës dhe kontratën për ndarjen e mjeteve, si dhe në përputhje me standardet dhe praktikat e mira teknike, ekonomike, financiare, menaxheriale, mjedisore dhe sociale dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në Republikën e Maqedonisë.
- (2) Shfrytëzuesi ka detyrimin ta zbatojë projektin në mënyrë efektive dhe efikase, në përputhje me aplikacionin e projektit dhe buxhetin e projektit.
- (3) Shfrytëzuesi ka detyrimin të mbajë shënime financiare dhe të kontabilitetit në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në mënyrën më të përshtatshme për aktivitetet e projektit, burimet në dispozicion dhe shpenzimet që lidhen me projektin dhe do të përgatisë raporte financiare për Fondin në përputhje me kontabilitetin në bazë monetare përkatësisht në para të gatshme, duke paraqitur qartë shpenzimet e kryera dhe dokumentet e pagesës për tremujorin për të cilën u përkasin, në atë mënyrë që përputhen me aktivitetet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin.
- (4) Fondi do t'u kërkojë shfrytëzuesve, si dhe furnizuesve, konsulentëve dhe pjesëmarrësve të përzgjedhur në projekt, t'u përmbahen standardeve më të larta etike në përputhje me udhëzimet kundër korrupsionit të Bankës Botërore ⁵dhe Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit, me qëllim parandalimin e korrupsionit dhe dukurive të lidhura me to gjatë zbatimit të kontratës.

⁵ Udhëzimet Kundër Korrupsionit të Bankës Botërore janë në dispozicion http://siteresources.worldbank.org/INTOFFEVASUS/Resources/WB_Anti_Corruption_Guidelines_10_2006.pdf

Neni 20

(1) Shfrytëzuesi është i detyruar të bëjë çdo blerje të mallrave dhe shërbimeve në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit dhe Konsulentëve të Bankës Botërore⁶ dhe praktikat e pranueshme tregtare të listuara këtu:

- Gjatë kryerjes së prokurimit të parashikuar në projekt, përdoruesit duhet të kenë parasysh nevojën ekonomike, efikasitetin, transparencën dhe kohëzgjatjen e procedurës së prokurimit si dhe cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të prokuruar.

- Për furnizimet e kryera në kuadër të instrumentit mbështetës - Grantet e bashkëfinancuara për shoqëritë tregtare të sapothemeluara start-up dhe spin-off që kalojnë vlerën 5,000.00 (pesë mijë) euro, shfrytëzuesi duhet të zhvillojë një procedurë duke mbledhur të paktën tre oferta. Shfrytëzuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin në Fond për miratim.

- Për prokurimet e kryera në kuadër të instrumenteve mbështetëse - Grantet e bashkëfinancuara dhe kreditë e kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve dhe grantet e bashkëfinancuara për shtrirje teknologjike që tejkalojnë 10,000.00 (dhjetë mijë) euro, shfrytëzuesi duhet të zhvillojë një procedurë duke mbledhur së paku tre oferta. Përdoruesi duhet të dorëzojë dokumentacionin në Fond për miratim.

- Në raste të arsyetuara, blerjet nga paragrafi 2 dhe paragrafi 3 i këtij neni mund të kryhen pa procedurën e përcaktuar të miratimit paraprak nga Fondi.

(2) Kur është e zbatueshme, marrëveshjet ndërmjet shfrytëzuesit dhe palëve të treta duhet të përfshijnë dispozita që lidhen me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, parandalimin e konfliktit të interesit, auditimin dhe ndikimin në mjedisin jetësor.

Neni 21

(1) Gjatë realizimit të projektit, shfrytëzuesi është i obliguar që të gjitha materialet promovuese të projektit t'i shënojë me logon dhe emrin e Fondit dhe të deklarojë qartë se projekti realizohet me ndihmën financiare të Fondit.

(2) Pajisjet e blera përmes projektit të financuar nga Fondi duhet të jenë të shënuara qartë me logon e Fondit, si dhe me shënimin: "Mbështetjet nga Fondi për inovacion dhe zhvillim teknologjik i Republikës së Maqedonisë".

(3) Nëse shfrytëzuesi posedon faqe interneti, ai është i detyruar të publikojë informacion të shkurtër për mbështetjen financiare të ofruar nga Fondi.

(4) Nëse shfrytëzuesi publikon ose bën deklaratë për media në lidhje me projektin, ai është i detyruar të përmendë mbështetjen e dhënë nga Fondi.

Neni 22

(1) Çdo ndryshim në projekt duhet të jetë i arsyetuar dhe në drejtim të arritjes së rezultateve të pritshme të projektit.

(2) Çdo devijim i rëndësishëm nga aplikimi i projektit dhe buxheti i projektit (ndryshime në planin e aktiviteteve që çojnë në një ndryshim në rezultatet e pritura të projektit, ndryshim në rezultatet e pritura të projektit, ndryshim në njerëzit kyç të projektit, transferim fondesh më i madh se sa lejohet sipas Rregullores për instrumentin përkatës etj.) duhet të miratohet më parë nga Fondi me kërkesën e paraqitur nga shfrytëzuesi.

⁶ Udhëzimet e Bankës Botërore për Keshilla dhe Udhëzimet për furnizimet janë në dispozicion në www.worldbank.org/procurement.

(3) Në rast të konvertimit të mjeteve të miratuara nga Fondi, shfrytëzuesii është i detyruar t'i realizojë shpenzimet në përputhje me Buxhetin e rishikuar të projektit.

Neni 23

(1) Shfrytëzuesi ka detyrimin të ruajë të gjithë dokumentacionin e projektit që nga fillimi i zbatimit të projektit.

Dokumentacioni i detyrueshëm i projektit përmban:

- dokumentacionin e projektit dhe dokumentacionin në lidhje me përdoruesin;
- të gjitha dokumentet zyrtare të komunikimit ndërmjet shfrytëzuesit dhe Fondit gjatë periudhës së aplikimit;
- njoftimi për ndarjen e mjeteve;
- kontrata për ndarjen e mjeteve;
- të gjitha dokumentet zyrtare gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe gjatë detyrimit të raportimit;
- kopjet origjinale të të gjitha raporteve të dorëzuara në Fond;
- njoftimet për miratimin e raporteve të paraqitura në Fond;
- kopjet origjinale të të gjitha faturave;
- të gjitha dokumentet e tjera duke përfshirë kontratat me palët e treta dhe dëshmi të tjera të pagesës në lidhje me projektin.

(2) Përdoruesi ka për obligim që dokumentacionin nga paragrafi (1) i këtij neni ta mbajë së paku 10 (dhjetë) vjet pas përfundimit të projektit.

(3) I gjithë informacioni në lidhje me kontratat dhe prokurimet në lidhje me projektin duhet të jetë i disponueshëm për inspektim nga përfaqësuesit e Bankës Botërore, punonjësit e Fondit dhe/ose personat e autorizuar nga Fondi.

VI. TË DREJTAT DHE DETYRIMET QË LIDHEN ME REZULTATET E PROJEKTIT

Neni 24

(1) Shfrytëzuesi do t'i marrë rezultatet e projektit që ai do të krijojë.

(2) Nëse shfrytëzuesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, Fondi rezervon të drejtën t'i kërkojë shfrytëzuesit që ta kthejë të gjithë shumën ose një pjesë të shumës së mjeteve të marra, të reduktuar për shumën e royalty të paguara, të ardhurat nga shitja e investimeve në shoqëritë e përsheptuara, principalin dhe/ose interesin e paguar në Fond. Për këto detyrime, Fondi rezervon të drejtën që nga dita e maturimit deri në ditën e faturimit të llogarisë të arkëtojë interes ndëshkues në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Neni 25

(1) Shfrytëzuesi është i detyruar të marrë masa për të siguruar shfrytëzimin komercial të rezultateve të projektit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në atë mënyrë që: t'i përdorë ato në kërkime të tjera që nuk përfshihen në projekt, të zhvillojë , krijojnë ose tregtojë një produkt ose proces, do të krijojnë ose ofrojnë një shërbim, ose do t'i përdorin ato për qëllime standardizimi.

(2) Shfrytëzuesi është i obliguar t'i ndërmarrë masat nga paragrafi (1) i këtij neni për kohëzgjatjen e projektit deri në përmbyshjen e të gjitha obligimeve ndaj Fondit në pajtim me marrëveshjen për ndarjen e mjeteve.

(3) Nëse shfrytëzuesii ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, Fondi rezervon të drejtën të kërkojë nga përfituesi që ta kthejë të gjithë shumën ose një pjesë të shumës së mjeteve të alokuara, të reduktuara për shumën e royalty të paguara, të ardhura nga shitja e investimeve në ndërmarrje të përsheptuara, principalin dhe/ose interesin e paguar në Fond. Për këto

detyrime, Fondi rezervon të drejtën që nga dita e maturimit deri në ditën e faturimit të llogarisë dhe të vendosë kamatë ndëshkuese ligjore në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Neni 26

(1) Shfrytëzuesi mund t'ia kalojë pronësinë e rezultateve të projektit palës tjetër, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

